



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 119, Datë 04.06.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“BLAÇ ENERGY” SH.P.K, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË NGA HEC “BLAÇ” ME FUQI TË INSTALUAR 1300 KW.**

Në mbështetje të neneve 16, 37 pika 2 gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, neneve 4 pika 1 gërma “a”; 5 pika 1 gërma “a”; 10 pika 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016, dhe nenit 19 pika 1, gërma “a” të “Rregullores së Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 04.06.2018 mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurave për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, të shoqërisë “BLAÇ ENERGY“ sh.p.k.,

Konstatoi se:

- Shoqëria “BLAÇ ENERGY” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën e protokolluar në ERE me nr. 379 Prot., datë 10.05.2018, për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “BLAÇ”, me fuqi të instaluar 1300 KW.
- Aplikimi i shoqërisë “BLAÇ ENERGY” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
 - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”; b” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4; 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me :

- Nenin 9, pika 2 gërma “d” (vërtetim nga Prokuroria dhe Gjykata);
- Nenin 9, pika 3, gërma “c” (dokumenta që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”*, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “BLAÇ ENERGY“ sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Blaç” me fuqi të instaluar 1300 KW, për një afat 30 – vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari
Petrit AHMETI